



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 6249 prot.

Ballsh, më 22.12.2023

VENDIM

Nr. 67 Datë 21/12/2023

PËR

**MIRATIMIN E PËRFUNDIMIT TË LIKUIDIMIT DHE ÇREGJISTRIMIN E
SHOQËRISË UK MALLAKASTËR**

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e takasave vendore”, Udhëzimit nr. 24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKB nr. 46, datë 30.08.2022 “Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të Ujësjetllës Kanalizimeve” Marrëveshjes së Bashkëpunimit për transferim aktiviteti nr. 1361 Rep., Nr. 619 Kol date 07.10.2022 ndermjet Sh.a Ujesjetllës Kanalizime Mallakaster dhe Shoqerise Rajonale Ujesjetllës Kanalizime Fier, VKB nr. 12, datë 24.02.2020 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak, materialit të paraqitur nga ana e Ujësjetllës Kanalizime Mallakastër sh.a. në lidhje me përfundimin e likuidimit dhe cregjistrimin e shoqërisë UK Mallakastër me anë të Vendimit Nr.09 datë 20.12.2023 “Për miratimin e përfundimit të likuidimit dhe cregjistrimin e Shoqërisë”,

VENDOSI

1. Miratimin e përfundimt të likuidimit dhe cregjistrimin e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Mallakastër sh.a. nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.
2. Ky vendim shoqërohet me dokumentacionin bashkëlidhur të paraqitur nga Ujësjetllës Kanalizime Mallakastër sh.a..
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit.

KRYETAR

Nexhmi Sulaj

